



**Republika e Kosovës**

Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Komuna Skenderaj**

Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Arsim / Direkcija za Obrazovanje / Department of Education**

**Nr. Prot: 338/2024**

**Data: 14.08.2024**

Në bazë të nenit 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197, nenit 62 paragrafi 62.3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregullores QRK Nr: 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, nenit 5 pikës c të Ligjit për Arsimin në Komunitatet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Drejtoria e Arsimit në Skenderaj shpall:

## **KONKURS PËR NJË PERIUDHË TË CAKTUAR**

<b>Nr</b>	<b>Niveli</b>	<b>Pozita e nëpunësve të Shërbimit Publik</b>	<b>Kohëzgjatja e emërimit</b>	<b>Numri i pozitave</b>	<b>Paga/koeficienti</b>
<b>1</b>	Shfmu	Mësimdhënës/e për biologji	Kohë të caktuar	1	E19 / 5.60
<b>2</b>	Shfmu	Mësimdhënës/e për lëndët e mjekësisë	Kohë të caktuar	3	E19 / 5.60
<b>3</b>	Shfmu	Mësimdhënës/e për mësim klasor	Kohë të caktuar	1	E19 / 5.60

### **I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë – nr 13);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit, **duhet të jenë të vërtetuara ose noterizuara;**
- Certifikatat e noterizuara (certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvijës në institucione arsimore (**nëse ka**).

### **II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (**Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138**) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të **MASHTI-it (UA Nr. 05/2021)** si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

### III. Vlerësimi i kandidatëve

- Me këtë konkurs do të zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2024/2025 (Shtator 2024 – Gusht 2025);
- Vlerësimi i kandidatit bëhet bazuar në **Rregullores QRK Nr: 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar**
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave publikohen në webfaqen e <https://kk.rks-gov.net/skenderaj/category/konkursey-njoftimet/> (konkurset).
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në web-faqen zyrtare të Komunës të Skenderajt;

### IV. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur **7 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **21.08.2024** deri më datën **27.08.2024**.
- Data e njoftimit është nga **20.08.2024**.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e komunës, kati i parë, sporteli Nr.13;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim.
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Rezultatet e konkursit do të shpallen në webfaqe të Komunës së Skenderajt.

**Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.**